


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.05.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 – 02-334/15, për z. Prekë Prekaj, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Istogut për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02 - 334/15, për zyrtarin e lartë Prekë Prekaj – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Istogut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Prekaj është hetuar për konflikt interesi për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.P.T. “Pali-Dioni”.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht i ka dërguar z. Prekaj shkresën zyrtare, njoftim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

z. Prekaj është bindur për kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë dhe ka premtuar që, në afatin ligjor, do ta shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se z. Prekaj ka emëruar një person të autorizuar për menaxhimin e biznesit privat "Pali-Dioni". Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

